



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
TIRANE

NR. 8247/3637/1417 AKTI

NR. 1068 VENDIMI

VENDIM  
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)----Kryesuese;  
ARJAN QAFJA-----Anetar  
ALKELINA GAZIDEDJA-----Anetare

Asistuar prej sekretares Besa Llabunishti , sot më dt.11/05/2016, pasi mori për shqyrtim ne dhomë këshillimi cështjen administrative me nr. 8247/3637/1417 Akti, me palë:

PADITËS: Shoqeria Tregetare “Redi” shpk Fier, me adresë të Shoqërisë Grizë e Portës Fier perfaqesuar me autorizim nga Av.Rozeta Plaku, Antare e Dhomes se Avokatise Fier, me nr.ligense 252.

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, perfaqesuar me autorizim nr.240 Prot, dat 01.2013, nga Admir Pahumi.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane perfaqesuar me autorizim nr.27473/1 Prot, date 10.01.2013, nga Admir Pahumi.

Me pjesmarrjen e Avokaturës se Shtetit, Zyra Vendore Vlore, perfaqesuar nga Av. Shtetit Endri Kotherja.

OBJEKTI: Pavlefshmëri absolute e Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore Nr.9037 datë 02.07.2012, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier.

Shfuqizimin e vendimit nr. 16890/5 Prot, date 21.11.2012, te Drejtorise se Apelimit Tatimor, pranë Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 324, 329, 331 te K.Pr.Civile, nenet 116/b/c e 138 të K.Pr.Administrative, nenet 71, 74, 88, 89, 90, 91 e 69 te Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 `` Per Procedurat Tatimore ne RSH``. Udhezimi nr.24 date 02.09.2008`` Per Procedurat Tatimore ne RSH``, Ligji Nr.7928, date 27.04.1995 i ndryshuar, Udhezimi nr. 17 datë 13.05.2012 i ndryshuar.

Se me vendimin nr. 578, datë 11.02.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur :

`` `` Pranimin e padise se pales paditese "Redi" shpk, Fier ndaj pales së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorisë së Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.9037 prot date 02.07.2012, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, mospranuar ankimi me vendim nr.16890/5 prot date 21.11.2012, te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Shpenzimet gjyqesore në ngarkim të palëve te paditura ne menyre solidare.

Kunder vendimit, lejohen ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore, brenda 15 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes ``

Kunder vendimit ka bere ankim Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë tërësisht, duke sjelle keto pretendime ndaj vendimit te gjykares:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier duhet të ketë në konsideratë se duhet të rrëzojë kërkesë-padinë sepse nuk plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative per ta cilësuar Njoftim Vlerësimit nr. 9829 Prot. datë 20.08.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm pasi institucioni që e ka nxjerrë aktin administrativ është Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Drejtorja Rajonale Tatimore Fier ka vepruar brenda kompetencave ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njoftim Vlerësimi nr. 13556 Prot datë 9.09.2011 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier ka

dale konform formes dhe procedurave ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. 9037 Prot datë 02.07.2012 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier i përcaktuar në vlerën 603.630 lekë është i bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Rezulton se nga inspektorët e verifikimit në terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier në zbatim të detyrave funksionale sipas Udhëzimit nr. 16, datë 3.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale” pika 18.6 është mbajtur ndaj tatimpaguesit akt-konstatimi nr. 0208953, datë 20.02.2012 sipas proces-verbalit të gjobës nr. 0062728, datë 20.02.2012 duke vendosur penalitetin në shumën 500.000 lekë sikurse proces-verbali i gjobës në vlerën 103.630 lekë për mosdeklarim të një punonjësi nga subjekti sipas nenit 122 pika 1 gërma “a, ii” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Rezulton se subjekti në ankimin përkatës nuk e ka kundërshtuar me asnjë provë mos instalim të kasës fiskale, kontrolli i dytë sikurse Vërtetimi i datës 24.05.2012 të Fakultetit të Shkencave Teknike të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë nuk përbën provë bindëse për të argumentuar se personi nuk punon në këtë Subjekt.

Drejtoria e Apelit Tatimor thekson se malli i kapur në momentin e kontrollit është realizuar nëpërmjet NBG Bank nuk përbën argument për t’u mos u pajisur subjekti me kasë fiskale sepse ky mjet duhet të pajisej me kasë fiskale sepse subjekti realizon shitje me para në dorë gjatë aktivitetit të tij.

Pra sipas nenit 122 pika 1 germa “a, ii” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka vepruar konform ligjit dhe akteve nenligjore pasi sipas nenit 108 pika 5 e ligjit dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave: “Në procedurën e barra e proves për të provuar që akti (ose mosveprimi) administrativ është i gabuar bie mbi ankuesin”.

Me vendimin nr. 16890/5 Prot, datë 21.11.2012 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve është vendosur: “Lënien në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore “gjobe” nr. 9037 Prot. datë 02.07.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për shumën 500.000 leke, për mosinstalim të kases, kontrolli i dytë dhe 103.630 leke për mosdeklarim të 1 (një) punonjësi”.

Pretendimet e pales paditese Shoqëria tregtare Redi sh.pk. nuk janë të bazuara sepse nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier janë respektuar dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe Udhëzimi nr. 24, datë 2.09.2008 i Ministrit të Financave.

Parashtrimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në Drejtorinë e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve Tirane nuk provojnë

ligjerisht se gjoba per shumen 500.000 leke per mos instalim te kases fiskale dhe kontrolli i dyte per shumen 103.630 leke per mos deklarim te nje punonjesi eshte i pasakte.

Prandaj dhe dokumentacioni i paraqitur ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane nuk eshte konsideruar prove e mjaftueshme per te vertetuar se vleresimi tatimor objekt ankimi ishte i pasakte.

Pretendimet e paraqitura nga paditesi subjekti "Redi" sh.p.k nuk permbajne asnje argument bindes per te pranuar padine nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier sepse nuk gjejne asnje mbeshtetje ligjore sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile e me tej te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise" dhe Udhezimit nr. 24, date 2.09.2008 i Ministrit te Financave.

Paditesi Shoqeria tregtare Redi sh.p.k. nuk ka arritur te arsyetoje gjate gjykimit dhe nuk dha asnje prove dhe argumet ligjor se perse akti administrativ Njoftim Vleresimi per detyrimet nr. 9037 Prot, date 02.07.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Fier e Vendimi nr. 16890/5 Prot, date 21.11.2012 i Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve duhet te konstatohen si te pavlefshme dhe se ku qendron paligjshmeria dhe ne kundërshtim se me cilin ligj jane nxjerre keto vendime.

Paditesi "Redi" sh.p.k. nuk ka paraqitur prova te bazueshmerise ne ligj te kerkimeve te tij sipas dispozitave ligjore dhe pra pretendimet nuk jane te mbeshtetura ne prova dhe ne ligj sepse paditesi gjate hetimit gjyqesor nuk paraqiti asnje dokument per te provuar pretendimet e tij ne kuptim te nenit 12 te Kodit te Procedures Civile: "pala qe pretendon nje te drejte, ka detyrim qe, ne perputhje me ligjin, te provoje faktet mbi te cilat provon pretendimet e tij".

**Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1235 datë 03.07.2014, ka vendosur: `` Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Apelit Vlorë, për gjykimin e çështjes civile nr. 2046 datë 13.05.2013 dhe dërgimin e akteve, për kompetencë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë``.**

### GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi degjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari kryesues Enkelejda Metaliaj ( Softa) , referuar akteve bashkengjitur dosjes Nr. 8247/3637/1417 , Dt.16.10.2014:

### VËREN

Vendimi nr.578, dt.11.02.2013 i Gjykates së Rrethit Gjyqësor Fier është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me provat e paraqitura nga palët

ndodhur në dosjen gjyqësore, e për rrjedhojë duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesë-padia.

- Nga aktet bashkengjitur dosjes që i perket vendimit objekt ankimi rezulton se, *Paditësi Shoqëria "Redi" sh.p.k. Fier ushtron aktivitetin e saj në fushën e tregtimit në Qarkun e Fierit.*

*Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, është ushtruar kontroll në Shoqëria "Redi" sh.p.k. Fier, në lidhje me pajisjen ose jo me kasa fiskale. Lidhur me kontrollin e ushtruar janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse, nëpërmjet të cilëve rezulton se kjo shoqëri nuk ka instaluar kase fiskale dhe ka një punonjes të padeklaruar.*

*Ne datën 20.02.2012, nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në baze të akt konstatimit nr. 0202953, kanë vendosur gjoben për shumën 500.000 leke, për mosinstalim të kases dhe kontrolli i detyrës 103.630 leke, për mosdeklarim të një punonjësi. Mbi këto baze, ka dalë Njoftim Vleresimi për Detyrimet Tatimore nr.9037 prot. dt.02.07.2012. Duke mos qenë dakort dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 609 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në R.SH", i është drejtur Drejtorisë së Apelit Tatimor, duke ushtruar rekursi administrativ për anulimin e Njoftimeve të Vleresimeve të Detyrimeve Tatimore, por nga ana e kësaj drejtorie, me vendimin 16890/5 datë 21.11.2012, është refuzuar akimi.*

*Ne këto kushte, paditësi duke mos qenë dakort me aktet administrative objekt shqyrtimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me objekt : **Pavlefshmëri absolute e Njoftim Vleresimi për Detyrimet Tatimore Nr.9037 datë 02.07.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Shfuqizimin e vendimit nr. 16890/5 Prot, datë 21.11.2012, të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tirane.***

Gjate gjykimit në shkallë të parë, pala paditëse ka pretenduar se aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor janë akte absolutisht të pavlefshme parashikuara nga nenet 116/b/c e 138 të K.Pr.Administrative , e për rrjedhojë ato duhet të shfuqizohen.

Gjate gjykimit në shkallë të parë, pala e paditur ka prapësuar të njëjtat fakte të konfirmuara se të njëjtat fakte të konfirmuara edhe në ankimin e saj kundër vendimit të gjykates së shkallës së parë, pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të parë .

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me Vendimin nr.578, dt.11.02.2013 ka vendosur Pranimin e kerkespadise, sipas disponimeve te pasqyruara ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke argumentuar nder te tjera se:

**Nga kontrolli i ushtruar prej inspektorëve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, ka rezultuar se subjekti Shoqëria "Redi" sh.p.k, nuk ka instaluar pajisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para në dorë.**

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.781 datë 14.11.2007, paditësi ka pasur detyrimin për të instaluar pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë deri në dhjetor 2009, detyrimi i cili nuk është përmbushur.

Në këto kushte, Njoftim vleresimi për detyrim tatimor nr. 9037 Prot, dt.02.07.2012, me të cilin detyrohet paditësi në shumën 500.000 lekë, lidhur me vendosjen e kases fiskale, nuk është marrë në përputhje me Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 pasi fillimisht vihet gjoba 100.000 lekë, e me pas, ne qofte se perseri nuk instalohet kasa fiskale, vihet gjoba prej 500.000 lekë, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me vendosjen e gjobes ne vleren 103.630 leke, per mosdeklarim te nje punonjesi plus kammat vonesat, gjykata konkludon se edhe ky akt konstatimi i Drejtories Rajnale Tatimore Fier eshte i pabazuar ne ligj, kjo per faktin se shtetasin Redion Zeqo eshte student prane Universitetit "Ismail Qemali" Vlore, fakt ky i provuar nga vertetimi 24.05.2012, leshuar nga ky Universitet. Gjithashtu, nga listpagesat e kesaj shoqerie, nuk rezulton qe shtetasi Redion Zeqo te jete punonjes prane kesaj shoqerie.

Per arsyet e sipërcituara, kërkimi i paditësi përse i përket anulimit të Njoftim Vlerësimit per detyrimin tatimor me nr. 9037 Prot dt.02.07.2012, është i pambështetur në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" si dhe në VKM Nr.781, datë 14.11.2007. Ne keto kushte, edhe vendimi nr. 16890 /5 Prot date 21.11.2012, i Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, duhet konsideruar absolutisht i pavlefshem.

Nder parimet e pergjithshme që udhëheqin organet e administrates në veprimtarinë e tyre, janë parimi i ligjshmërisë dhe ai i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë, parashikuar respektivisht nga nenet 9 dhe 10 te K.Pr. Administrative.

Parimi i ligjshmërisë kërkon jo vetëm që autoritetet administrative të mos shkelin ligjin, por edhe që të gjitha aktet e nxjerra prej tyre të jenë të autorizuar qartë nga ligji dhe përmbajtja e këtyre akteve të jetë në përputhje me atë ligj.

Parimi i sanksionuar në nenin 10 të Kodit të Proedurave Administrative, realizon një balancim të drejtë midis interesave publike dhe atyre private, duke qenë të dyja këto të ligjshme.

Në rastin konkret, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nuk është respektuar parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë, si dhe parimi i ligjshmërisë që ka të bëjë me respektimin e detyrimeve që parashikohen në nenin 122 të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", qëllim i të cilit, është mbrojtja në mënyrë reciproke e interesave financiaro- publike dhe të drejtave të personave tatimpagues.

Arësyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit është si më poshtë: Në analizë të provave, shpjegimeve të palëve, shkaqeve të ngritura në ankim dhe ligjit të aplikueshëm në rastin konkret, kolegji administrativ vlerëson se vendimi objekt gjykimi duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesë-padia si e pambështetur në ligj dhe në prova me arsyetimin si më poshtë vijon:

Paditësi të gjithë arsyetimin e tij në lidhje me paligjshmërinë e akteve administrative objekt shqyrtimi i është referuara neneit 116/ b, c të K.Pr.Administrative.

Që të jemi përpara kushteve të parashikuara nga neni 116, pika b dhe c të K.Pr.Administrative duhet ti referohemi vetë dispozitës'

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Në analizë të dispozitës së lartpërmendur dhe akteve administrative objekt shqyrtimi Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka vepruar brenda kompetencave ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njoftim Vlerësimi nr. 13556 Prot datë 9.09.2011 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier ka dale kompetencave që ka në këtë rast pala e paditur DRT Fier ( ligjit të lartpërmendur) dhe konform formes dhe procedurave ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. 9037 Prot datë 02.07.2012 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier i përcaktuar në vlerën 603.630 lekë është i bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në lidhje me pikë “ b” të nenit 116 të K.Pr.Administrative , kjo gjykatë sqaron se cdo organ administrativ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe nuk mundet të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër administrativ, pasi ushtrimi i kompetencave tej kufijve të ligjit përbën cënim të parimit të ligjshmërisë dhe si rrjedhojë cdo veprim apo akt administrativ që mund të nxirret nga kjo veprimtari e pakufizuar dhe arbitrare shpie domosdoshëmrisht në pavlefshmërisë juridike të tyre. Pra akti administrativ do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm jo vetëm në rastet kur organi administrativ nuk është kompetent apo kur kapërcen kufijtë e kompetencës së tij, por dhe kur çështja që ai zgjidh nuk hyn në juridiskionin e tij administrativ. Në rastin konkret sikundër u citua sa sipër palët e paditura DRT Fier dhe DAT Tiranë janë brenda kompetencave të parashikuara nga ligji 9920/2008, Neni 14 nga ku ndër të tjera citohet se

- 1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve, siç parashikohet në nenin 4 të këtij ligji.*
- 2. Drejtoria rajonale varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.*
- 3. Drejtoria rajonale drejtohet nga drejtori i drejtorisë rajonale.*

Në lidhje me pikën “c” të nenit 116 të K.Pr.Administrative Sipas doktrinës respektimi i formës dhe i procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ përbën një element të rëndësishëm që përcakton vlefshmërinë e tij. Shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë absolute të aktit. Pavarësisht se shkronja “c” e nenit 116 i referohet cdo lloj shkeljeje të formës apo procedurës që ta quajë aktin absolutisht të pavlefshëm , ndoshta dispozita nuk duhet kuptuara në këtë mënyrë. Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë e atij karakteri dhe asaj rëndësie që të ketë ndikuar drejtëpërsëdrejti në nxjerrjen e aktit administrativ

Rezulton se nga inspektorët e verifikimit në terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier në zbatim të detyrave funksionale sipas Udhëzimit nr. 16, datë 3.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale“ pika 18.6 është mbajtur ndaj tatimpaguesit akt-konstatimi nr. 0208953, datë 20.02.2012 sipas proces-verbalit të gjobës nr. 0062728, datë 20.02.2012 duke vendosur penaltetin në shumën 500.000 lekë sikurse proces-verbali i gjobës në vlerën 103.630 lekë për mosdeklarim të një punonjësi nga subjekti sipas nenit 122 pika 1 gërma “a, ii“ të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“.

Rezulton se subjekti në ankimin përkatës nuk e ka kundërshtuar me asnjë provë mos instalim të kasës fiskale, kontrolli i dytë sikurse Vërtetimi i datës 24.05.2012

të Fakultetit të Shkencave Teknike të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë nuk përbën provë bindëse për të argumentuar se personi nuk punon në këtë Subjekt.

Drejtorja e Apelit Tatimor thekson se malli i kapur në momentin e kontrollit është realizuar nëpërmjet NBG Bank nuk përbën argument për t'u mos u pajisur subjekti me kasë fiskale sepse ky mjet duhet të pajisej me kasë fiskale sepse subjekti realizon shitje me para në dorë gjatë aktivitetit të tij.

Pra sipas nenit 122 pika 1 germa "a, ii" të ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë" Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka vepruar konform ligjit dhe akteve nenligjore pasi sipas nenit 108 pika 5 e ligjit dhe Udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 te Ministrit te Financave: "Në procedurën e barra e proves për të provuar që akti (ose mosveprimi) administrativ është i gabuar bie mbi ankuesin".

Me vendimin nr. 16890/5 Prot, date 21.11.2012 te Drejtorise se Apelit Tatimor pranë Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve është vendosur: "*Lënien ne fuqi te aktit administrativ objekt ankimi, Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore "gjobe" nr. 9037 Prot. date 02.07.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier per shumen 500.000 leke, per mosinstalim te kases, kontrolli i dyte dhe 103.630 leke per mosdeklarim te 1 (nje) punonjesi*".

Në vijim të sa sipër, kjo gjykatë cmon se pretendimet e pales paditese Shoqeria tregtare Redi sh.pk. nuk janë të bazuara sepse nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier janë respektuar dispozitat e ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 dhe Udhezimi nr. 24, date 2.09.2008 i Ministrit te Financave.

Parashtrimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti ne Drejtorine e Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane nuk provojne ligjerisht se gjoba per shumen 500.000 leke per mos instalim te kases fiskale dhe kontrolli i dyte per shumen 103.630 leke per mos deklarim te nje punonjesi eshte i pasakte.

Paditesi Shoqeria tregtare Redi sh.p.k. nuk ka arritur te arsyetoje gjate gjykimit dhe nuk dha asnje prove dhe argumente ligjor se perse akti administrativ Njoftim Vleresimi per detyrimet nr. 9037 Prot, date 02.07.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Fier e Vendimi nr. 16890/5 Prot, date 21.11.2012 i Drejtorise se Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve duhet te konstatohen si te pavlefshme dhe se ku qendron paligjshmeria dhe ne kundërshtim se me cilin ligj janë nxjerre keto vendime.

Është e vërtetë që sipas nenit 17/2 të ligjit 49/2012 "*Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme . Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe vep-rimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët*" por , në rastin konkret paditësi ka shtrirë kërkimin e tij në lidhje me aktet

administrative objekt shqyrtimi gjyqësor vetëm tek pavlefshmëria absolute sipas kushteve të parashikuara nga neni 116/b,c të K.,Pr. Administrative, e kjo gjykatë sa sipër analizoi kushtet e kësaj dispozite duke argumentuara se aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor janë nxjerrë konform ligjit 9920/2008 i ndryshuar ( brenda kompetencave që kanë palët e paditura në nxjerrjen e tyre) dhe, se është respektuara dhe forma dhe procedura për nxjerrjen e tyre, cka do të thotë se vendimet Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore Nr.9037 datë 02.07.2012, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier lënë në fuqi me vendimin nr. 16890/5 Prot, date 21.11.2012, te Drejtorise se Apelit Tatimor, pranë Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane duhet të mbeten në fuqi. Mbështetur në nenin 45/b të ligjit 49/2012 ndaj këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

Shpenzime gjyqësore lidhur me kete çeshtje ne Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk u kryen.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar ne Nenin 50/c te Ligjit Nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”,

### VENDOSI

- Ndryshimin e vendimit nr.578, dt.11/02/2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rrëzimin e kërkesë-padisë si të pambështetur në ligj.
- Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë.
- U shpall sot 11/05/2016 në Tiranë.

ANTAR	ANTARE	KRYESUESE
ARJAN QAFA	ALKELINA GAZIDEDJA	ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)
DV	DV	DV

E NJESUAR ME ORIGJINALIN

*Kancelari*  
*Leonard Steady*  
*Steady*